

## **Pas avionit, qëllohet edhe një helikopter rus (Video)**

Krijuar: Marte, 24 Nentor 2015 19:31

---

Pas rrëzimit të avionit luftarak rus nga Turqia, njoftohet edhe për rrëzimin e një helikopteri rus.

Në një video të publikuar shihen ushtarët e Ushtrisë së Lirë Siriane se si godasin helikopterin rus i cili kishte dalë në kërkim të pilotit të avionit të rrëzuar.

Observatori Sirian për të Drejtat e Njeriut, me bazë në Britani, ka thënë se kryengritësit kanë goditur helikopterin me një raketë antitank.